



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike.

Ju mund të ndihmoni në parandalimin dhe zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike, duke përdorur këtë analizë të thjeshtë TAMS të ndarë në katër pjesë.



Ky botim është financuar nga BE në kuadër të
projektit të Asistencës Teknike EuropeAid/128368/C/SER/AL
*"Mbështje për Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës
dhe Departamentin e Ndihmës Ekonomike"*

T - Tregu



Kush është në treg për këtë Ofertë?

Zbuloni se sa operatorë ekonomike mund të konkurrojnë për Oferta dhe cilët operatorë ekonomikë janë pozicionuar më mirë që të mbajnë ofertën. Marrëveshja në oferta ndodh nëse:

- Janë pak operatorë ekonomik në treg që ofrojnë të mira ose shërbime.
- Kur një grup i vogël operatorësh kontrollojnë një pjesë të gjerë të tregut.
- Kriteri përcaktues në shpalljen e ofertës fituese është çmimi dhe jo kriteret e tjerë konkurrues si dizenjimi, cilësia apo shërbimi.

A - Aplikimi



A ka shenja të ngjashme mes kërkesave ose propozimeve të operatorëve ekonomikë?

Shqyrtoni drejtpërdrejtë propozimet ose kërkesat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë konkurrues dhe shikoni për shenja të ngjashme. Marrëveshja në oferta ndodh nëse:

- Dy ose më shumë propozime përmbajnë të njëjtin shkrim dore, gabime daktilografimi ose gabime matematikore.
- Dy ose më shumë propozime janë dërguar nga e njëjta adrese e-maili, numër fax-i ose e njëjta vulë postare.
- Dy ose më shumë propozime reflektojnë se ndryshimet e fundit janë bërë për të ndryshuar çmimet.
- Karakteristikat e dokumentit të dy ose më shume propozimeve elektronike tregojnë që janë krijuar ose ndryshuar nga një operator ekonomik.

Nëse ju vini re çdo kombinim të këtyre sinjaleve, Ju duhet të raportoni shqetësimin tuaj tek:

Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut, Sektori Anti-kartel.

www.caa.gov.al

E-mail: competition@caa.gov.al

Tel: +355 4 2234504/ ext 225 / Fax: +355 4 2234 497

M - Modelet



A janë zhvilluar modele midis ofertuesve konkurrues?

Shqyrtoni rezultatet e ofertave të mëparshme për produkte apo shërbime të njëjta që të identifikoni modelet me kalimin e kohës. Marrëveshja në oferta ndodh nëse:

- Përgjatë disa ofertimeve të njëpasnjëshme, ofertuesit konkurrues ndjekin parimin e rotacionit në të qënurit fitues.
- Përgjatë disa ofertimeve të njëpasnjëshme të njëjtit konkurrentë fitojnë oferta me fond limit të njëjtë ose të përafërt.
- Përgjatë disa ofertimeve të njëpasnjëshme, fiton gjithmonë i njëjti konkurrent.
- Operatori ekonomik që fiton, nënkontraktin dhe i jep tenderin ofertuesit që ka humbur ose ofertuesit që është tërhequr nga tenderi ose që ka refuzuar të paraqesë një propozim.
- Duke bërë një krahasim me ofertat e mëparshme, në tenderin në fjalë paraqesin propozime një numër më i vogël ofertuesish.

S - Sjellje e dyshimtë

A kanë demonstruar ofertuesit sjellje që tregojnë se ato punojnë së bashku për ofertime?

		Player B	
		Cooperate	Detect
Player A	Cooperate	+1	+3
	Detect	-1	0

Arrows in the table indicate the following transitions: a red arrow from (Cooperate, Cooperate) to (Cooperate, Detect); a red arrow from (Cooperate, Cooperate) to (Detect, Cooperate); a blue arrow from (Cooperate, Detect) to (Detect, Detect); and a blue arrow from (Detect, Cooperate) to (Detect, Detect).

Shikoni me kujdes sjelljet e dyshimta që tregojnë se ofertuesit kanë bashkëpunuar me njëri tjetrin sesa kanë konkurruar për të fituar tenderin. Marrëveshja në oferta ndodh nëse:

- Një ofertues dorëzon kërkesë për një prokurim, dhe ju jeni në dijeni që ofertuesi nuk ka mundësi që të ofrojë të mirat dhe shërbimet e kërkuara.
- Një ofertues i vetëm sjell propozime të shumta për një proces ofertimi.
- Një ofertues bën deklarata me telefon ose me e-mail duke treguar se ka njohuri mbi çmimet e një konkurrenti tjetër ose mundësitë e tij për të fituar ofertën.